


Tregtia e jashtme e mallrave

Maj 2025

Tiranë, më 17 Qershor 2025: Në Maj 2025 eksportet e mallrave arritën vlerën 35 mld lekë, duke u rritur me 1,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 6 %, në krahasim me Prill 2025. Importet e mallrave arritën vlerën 78 mld lekë, duke u ulur me 2,1 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 2,6 %, në krahasim me Prill 2025. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 42 mld lekë, duke u ulur me 4,6 %, krahasuar me Maj 2024 dhe 0,05 %, në krahasim me Prill 2025.


Fig.1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)



Në këtë pesërmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 168 mld lekë, duke u rritur me 2,1 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 355 mld lekë, duke u ulur me 2,4 %, krahasuar me një vit më parë. Defiçiti tregtar arriti vlerën 187 mld lekë, duke u ulur me 6,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2024.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:


Gjatë muajit Maj 2025, në rritjen e eksporteve prej 1,2 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +6,2 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,4 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +1,0 pikë përqindje. Negativisht ka ndikuar grupi: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -5,8 pikë përqindje, etj.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Maj 2025

Eksportet, gjatë këtij pesërmujori janë rritur me 2,1 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +8,3 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +0,8 pikë përqindje, etj. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -6 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -0,7 pikë përqindje, etj.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Maj 2025, në uljen e importeve prej 2,1 %, krahasuar me Maj 2024, kanë ndikuar negativisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,2 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqim, pije, duhan” me +0,8 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,5 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me +0,4 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Maj 2025

Si pesërmujor, importet janë ulur me 2,4 %, krahasuar me pesërmujorin e parë 2024. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -2,7 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,8 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +0,7 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +0,4 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +0,3 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Maj 2025, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Maj 2024 janë: Kosova (51,5 %), Spanja (33,7 %), Turqia (53,2 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (8,0 %), Greqia (3,1 %) dhe Gjermania (4,3 %).

Gjatë këtij pesërmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kosova (74,1 %), Greqia (6,6 %) dhe Gjermania (4,5 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (11,6 %) dhe Maqedonia e Veriut (31,0 %).

Në muajin Maj 2025, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, janë: Italia (3,6 %) dhe Turqia (7,5 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kina (25,1 %), Greqia (1,2 %) dhe Gjermania (4,0 %).

Gjatë këtij pesërmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (1,8 %), Turqia (19,3 %) dhe Gjermania (6,4 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritje më të madhe janë: Kina (24,0 %), Greqia (2,6 %) dhe Spanja (8,7 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Maj 2025



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 56,9 %, të gjithë tregtisë. Në Maj 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 66,4 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 52,6 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (27,2 %), Kina (8,4 %), Greqia (7,3 %) dhe Turqia (7,1 %).

Shkëmbimet tregtare, për pesërmujorin e parë 2025, me vendet e BE-së zënë 57,2 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Maj 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 67,2 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 52,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (27,2 %), Kina (8,6 %), Greqia (7,7 %) dhe Turqia (7,4 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Maj 2025

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2023		440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2024		373	-15,4	894	2,5	-522	41,7
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	05 - 23	40	-11,7	81	1,2	-41	49,2
	06 - 23	38	-17,3	75	-7,5	-37	50,7
	07 - 23	38	-4,0	71	-13,6	-33	53,7
	08 - 23	27	-21,9	68	-15,0	-40	40,6
	09 - 23	34	-12,8	73	-16,6	-40	45,8
	10 - 23	37	-4,3	78	-6,3	-42	46,8
	11 - 23	33	-21,8	72	-7,4	-39	46,0
	12 - 23	38	-6,6	73	-23,1	-35	51,7
	Jan-Dhj 23	440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2024	01 - 24	30	-29,2	60	3,4	-30	49,5
	02 - 24	32	-16,1	74	6,4	-42	43,5
	03 - 24	33	-21,0	75	-7,0	-42	44,4
	04 - 24	35	1,8	75	0,6	-41	45,9
	05 - 24	35	-12,4	79	-1,6	-45	43,8
	06 - 24	35	-8,9	77	2,1	-42	45,3
	07 - 24	33	-12,0	85	21,1	-52	39,0
	08 - 24	22	-18,2	69	1,9	-46	32,6
	09 - 24	31	-8,5	71	-3,1	-40	43,3
	10 - 24	31	-15,2	77	-1,5	-46	40,3
	11 - 24	30	-8,5	73	2,0	-43	41,2
	12 - 24	26	-31,7	79	8,3	-53	32,6
	Jan-Dhj 24	373	-15,4	894	2,5	-522	41,7
2025	01 - 25	31	4,9	60	0,1	-29	51,8
	02 - 25	34	4,3	68	-8,6	-34	49,7
	03 - 25	35	4,9	74	-1,4	-39	47,3
	04 - 25	33	-4,1	76	0,4	-43	43,8
	05 - 25	35	1,2	78	-2,1	-42	45,3
	Janar-Maj 25	168	2,1	355	-2,4	-187	47,3

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milione lekë), Maj 2025

	Eksporte				Importe			
	Maj 2024	Maj 2025	Jan. - Maj 2024	Jan. - Maj 2025	Maj 2024	Maj 2025	Jan. - Maj 2024	Jan. - Maj 2025
Vendet e BE-së	23.684	23.362	118.547	112.878	41.653	40.855	189.912	186.257
Austri	211	120	1.124	721	719	701	3.099	3.050
Gjermani	1.814	1.736	9.265	9.680	5.108	5.312	26.308	24.612
Greqi	2.215	2.147	10.066	10.729	5.959	6.032	28.592	29.345
Itali	14.451	13.300	73.341	64.854	18.053	17.396	78.959	77.531
Spanjë	1.126	1.506	5.540	7.804	1.330	1.570	5.538	6.019
Kroaci	419	316	2.135	1.040	314	647	1.342	2.552
Të tjera të BE-së	3.447	4.240	17.076	18.050	10.170	9.197	46.073	43.148
Mbretëri e Bashkuar	119	103	648	526	981	940	4.124	3.647
Kinë	1.349	578	4.410	3.572	7.069	8.842	33.434	41.448
Kosovë	3.855	5.840	16.495	28.724	1.152	908	4.831	4.720
Maqedonia e Veriut	1.365	929	6.371	4.393	1.146	1.198	4.936	5.238
Rusi	-	-	5	6	231	391	1.362	1.571
SHBA	278	423	1.815	1.831	1.085	1.235	8.807	7.323
Turqi	285	437	1.819	2.196	8.183	7.567	44.932	36.271
Ukrainë	542	0	710	296	372	282	1.859	1.705
Zvicër	230	132	943	499	474	422	2.934	3.650
Të tjera	3.044	3.352	12.771	13.060	16.958	15.008	66.427	63.057
Gjithsej	34.752	35.159	164.536	167.980	79.306	77.649	363.557	354.887

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milione lekë), Maj 2025

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Maj 2024	Maj 2025	Jan. - Maj 2024	Jan.-Maj 2025	Maj 2024	Maj 2025	Jan. - Maj 2024	Jan.-Maj 2025
Gjithsej	34.752	35.159	164.536	167.980	79.306	77.649	363.557	354.887
Ushqime, pije, duhan	5.441	5.920	22.681	23.959	13.528	14.171	60.870	62.435
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	6.582	8.733	32.377	46.035	7.504	6.254	34.375	36.762
Produkte kimike dhe plastike	1.276	1.207	6.436	5.363	9.860	10.246	48.194	49.362
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	154	147	981	822	1.151	1.138	5.291	4.970
Prodime druri dhe letre	826	870	4.195	4.228	2.734	2.610	12.075	11.793
Tekstile dhe këpucë	9.379	9.723	46.152	45.440	7.600	7.916	35.268	35.402
Materiale ndërtimi dhe metale	6.230	4.214	30.820	20.875	11.524	10.603	52.034	49.060
Makineri, pajisje dhe pj. këmb.	3.421	3.391	15.945	16.508	21.507	21.295	99.305	89.380
Të tjera	1.441	955	4.950	4.752	3.898	3.414	16.145	15.723

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Maj 2025

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	73.341	64.854	16.495	28.724	10.066	10.729	9.265	9.680
Ushqim, pije duhan	6.176	5.527	2.472	2.671	1.755	1.998	647	687
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	6.243	2.339	3.704	21.403	1.165	1.272	2.935	2.179
Produkte kimike dhe plastike	2.457	1.804	1.646	1.244	404	334	16	28
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	813	677	3	11	124	76	1	-
Prodhime druri dhe letre	2.264	2.362	475	443	660	669	54	45
Tekstile dhe këpucë	34.875	33.107	72	40	3.487	3.923	3.957	4.585
Materiale ndërtimi dhe metale	9.742	8.940	6.619	1.249	1.995	1.872	261	426
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	8.451	7.709	952	1.203	116	110	1.227	1.491
Të tjera	2.322	2.388	551	461	360	475	167	240

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Maj 2025

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	78.959	77.531	44.932	36.271	33.434	41.448	28.592	29.345
Ushqim, pije duhan	12.250	13.399	2.385	2.269	735	826	7.929	8.431
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	1.791	3.032	6.412	3.209	6	8	4.241	4.545
Produkte kimike dhe plastike	9.782	9.766	4.906	4.939	2.714	3.448	4.908	5.287
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	4.162	3.870	149	196	361	366	107	60
Prodhime druri dhe letre	2.508	2.513	2.031	1.777	647	793	1.665	1.694
Tekstile dhe këpucë	15.586	15.256	4.728	4.057	5.291	5.557	2.781	2.945
Materiale ndërtimi dhe metale	9.662	9.271	12.466	12.745	4.777	6.621	4.128	3.568
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	18.928	16.429	10.035	5.290	15.894	20.235	1.764	1.924
Të tjera	4.290	3.996	1.821	1.789	3.010	3.595	1.070	890

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri